



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:019047

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05451198

C.nr.28/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore e paditëses F.K nga Istogu, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Merita Binakaj avokate në Deçan, rruga “Sali Çeku” pn., kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas objektit të kontestit kompensim i shpenzimeve të ushqimit/shujtave ditore për ditët e prezencës në punë, jashtë seancës gjyqësor, me datë 13.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.K nga Istogu, ashtu që, DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore për 242 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, duke e llogaritur prej datës 01.09.2021 deri me datën 21.11.2022, t’ia kompensojë shumën në lartësi prej 484.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë, gjegjësisht, nga data 16.01.2023 e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurale në shumë të përgjithshme prej 125 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Fikrije Kajtaçaj, përmes përfaqësueses së autorizuar ka parashtruar në këtë gjykatë padi me datën 16.01.2023, kundër të paditurës Komuna Istogut – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit, kompensim e shpenzimeve të ushqimit/shujtave ditore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 23.11.2023, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 24.11.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t’i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë për paditësen F.K del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga: kontrata me nr. protokollit 461/21 e datës 15.09.2021 e lidhur në mes të paditurës dhe këtu paditëses nga e cila vërtetohet se paditësja është në marrdhënie pune te e paditura si mësuese e klasës së bashkangjitur në në Sh.f.m.u “Bajram Curri” në Istog, ndërsa, nga vërtetimi më numër të protokollit 830 i datës 16.12.2022 i lëshuar nga sh.f.m.u “Bajram Curri” u vërtetuan 242 ditët e prezencës në punë të paditëses për vitin shkollor 2021/2022 dhe atë 2022/2023 e deri më datën 21.11.2022, për të cilat ditë paditësja kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit.

Gjykata përveç kërkesës kryesore në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, ka vendosur edhe për kamatën ligjore, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ashtu që ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 16.01.2023), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës ashtu që lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet 104 euro për përpilim të padisë dhe 21 euro për taksë gjyqësore.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c te LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit te datës 22.01.2021 dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 parg.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile
C.nr.28/23 data 13.03.2024

Gj y q t a r j a
Lirika SYLAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykatë.